



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



RREGULLORE Nr. 01/2020, E PUNËS SË ORGANIT SHQYRTUES TË PROKURIMIT

Në bazë të nenit 142 (Kapitulli XII) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe pjesëve VIII dhe IX të Ligjit për Prokurim Publik Nr. 04/L-042 të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237, ligjin nr. 05/L-068 dhe ligjin nr. 05/L-092 (këtej e tutje referuar si “LPP”), Bordi i Organit Shqyrtues të Prokurimit, në takimin e mbajtur me datën 26 shkurt 2020, miraton:

RREGULLOREN E PUNËS SË ORGANIT SHQYRTUES TË PROKURIMIT

PJESA I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

1. Objekt i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave për procedurën e shqyrtimit të ankesave në lidhje me rregullat e procedurës së prokurimit publik, mënyrën e punës së Organit Shqyrtues për Prokurim Publik dhe vendimmarrjes, në lëndët të cilat janë objekt trajtimi dhe kompetencë e Organit Shqyrtues të Prokurimit, si dhe çështjet tjera të rëndësishme për veprimin dhe punën e Organit Shqyrtues të Prokurimit.
2. Rregullat gjithashtu ofrojnë udhëzime specifike për implementimin e funksioneve të ndryshme të Organit Shqyrtues të Prokurimit. Në këtë aspekt, këto mund të shërbejnë si *udhëzues i brendshëm* për të gjithë punëtorët e Organit Shqyrtues të Prokurimit, duke ngritur njohuritë e secilit nga punëtorët për përgjegjësitë tyre ndaj organizatës dhe publikut në përgjithësi.
3. Çështjet që ndërlidhen me punën e Organit Shqyrtues të Prokurimit, e të cilat nuk janë të rregulluara me këtë rregullore, mund të rregullohen me vendim të veçantë të Bordit të Organit Shqyrtues të Prokurimit, duke u mbështetur në këtë Rregullore dhe LPP.

Neni 2 **Përkufizimet**

1. Për qëllim të kësaj rregulloreje nocionet e mëposhtme kanë këtë përkufizim:

1.1 **OSHP** –është shkurtesë për Organi Shqyrtues i Prokurimit.

1.2 **Palë** - është çdo person i cili në lëndët e trajtuara nga OSHP, paraqitet në cilësi të autoritetit kontraktues, ofertuesit, personit të interesuar, përfaqësues ligjor apo i autorizuar i tyre.

1.3 **Konflikt i interesit** - është situata kur Kryetari apo anëtarët e OSHP-së, një Ekspert shqyrtues i OSHP-së, ekspert profesional ose një ekspert i jashtëm, kanë interes privat i cili mund të ndikojë në vendimmarrje në lëndët që janë objekt i trajtimit në OSHP, dhe mund të rrezikojë interesin publik dhe punën e OSHP-së.

1.4 **Rast** - është çështja juridike në të cilën vendos paneli shqyrtues në kuadër të kompetencave të veta konform LPP-së.

1.5 **Paneli shqyrtues** - i themeluar në pajtim me këtë rregullore të punës.

1.6. **Ekspert shqyrtues i OSHP-së** - është eksperti shqyrtues, punonjës i OSHP-së përgjegjës për shqyrtim të ankesave në përputhje me kërkesat e LPP-së dhe rregulloreve të brendshme të OSHP-së.

1.7 **LPP** - Ligji për Prokurimin Publik i Republikës së Kosovës .

2. Në pajtim me parimin e barazisë gjinore, të gjitha përkufizimet e përdorura në formën gramatikore mashkullore, do të përdoren si neutrale për femra dhe meshkuj.

Neni 3 **Organi Shqyrtues i Prokurimit**

1. OSHP është një organ i pavarur administrativ për shqyrtim të ankesave, që është përgjegjës për ushtrimin dhe ekzekutimin e autoriteteve, fuqive, funksioneve dhe përgjegjësi të specifikuar në dispozitat e Ligjit të Prokurimit Publik.

2. Selia e OSHP-së është në Prishtinë, Republika e Kosovës.

3. OSHP është autoritet publik dhe një organizatë buxhetore e pavarur, përdorues i pavarur i buxhetit. OSHP i nënshtrohet të gjitha ligjeve dhe rregulloreve të Republikës së Kosovës në të njëjtën masë si çdo përdorues tjetër i buxhetit.
4. Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP-së dhe stafi i sekretariatit të OSHP-së janë shërbyes civil. Statusi i shërbyesit civil nuk është i aplikueshëm për anëtarët e bordit apo konsulentët e pavarur.
5. Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP-së, zhvillon procedurat e rekrutimit të shërbyesve civil dhe praktikantëve konform legjislacionit në fuqi. Metoda e kompensimit të praktikantëve, nëse e aplikueshme, rregullohet me akt të veçantë të nxjerrë nga sekretariati i OSHP-së.

Neni 4 Gjuha Zyrtare

1. Gjuhët zyrtare të OSHP-së janë ne përputhje me nenin 13 të LPP-së.

Neni 5 Parimet

1. Gjatë ushtrimit të funksionit të shqyrtimit të ankesave, OSHP-ja udhëhiqet nga këto parime:
 - 1.1 Ligjshmërisë;
 - 1.2 Barazisë dhe mosdiskriminimit;
 - 1.3 Pavarësisë dhe paanësisë ne vendimmarrje;
 - 1.4 Parimi i kontradiktoritetit të procedurës;
 - 1.5 Transparencës dhe informimit të publikut;
 - 1.6 Mbrojtjes së të dhënave personale, sekretit shtetëror ose tregtar;
 - 1.7 Parandalimin e konfliktit të interesit;
 - 1.8 Parandalimin e korrupsionit;
 - 1.9 Efikasiteti;
 - 1.10 Ruajtjes së vlerës për para;
 - 1.11 Mbrojtjes së interesit publik.

Neni 6

Transparenca e punës

1. Kryetari duhet të sigurojë transparencë të punës së OSHP-së. OSHP do të informoj publikun për punën e saj dhe konstatimet përmes prezantimit të raportit vjetor të punës së OSHP-së të publikuar në uebfaqen e OSHP-së dhe kurdo që është e nevojshme, përmes konferencave për media.
2. Kryetari i OSHP-së ose personi i autorizuar nga ai si dhe anëtarët individual, me autorizim nga Kryetari, do të informojnë publikun për punën e përditshme të OSHP-së.
3. OSHP përmes publikimit në faqen e internetit, bënë të ditur datën dhe kohën e mbajtjes së seancave.
4. Vendimet e OSHP-së, në shqyrtimin e ankesave do të publikohet brenda pesë (5) ditëve nga data e nënshkrimit të vendimit në faqen e internetit të OSHP-së, në gjuhën origjinale të vendimit dhe brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve sa i përket gjuhëve tjera, si dhe në gjuhën angleze për të gjitha rastet e kontratave me vlerë të lartë.
5. Vendimet e OSHP-së do të publikohen në version të plotë, përveç nëse disa pjesë të vendimit përmbajnë të dhëna personale apo të dhëna të klasifikuara si konfidenciale. Këto pjesë do të bëhen anonime para publikimit.
6. OSHP do të sigurojë qasje të drejtpërdrejtë në internet për seancat dëgjimore publike për shqyrtim kryesor me palë. OSHP do të sigurojë funksionimin e duhur dhe të qëndrueshëm të pajisjeve për transmetim të drejtpërdrejtë, duke ofruar edhe zgjidhje të shpejtë në rast të mosfunksionimit të tyre. Përrjashtimisht, kur është e pamundur, OSHP nuk do t'i transmetoj seancat dëgjimore drejtpërdrejtë përmes internetit.

Neni 7

Ruajtja e sekreteve

1. Në kryerjen e punëve të tyre, të gjithë zyrtarët e OSHP-së, si dhe profesionistët e pavarur dhe ekspertët dhe të gjitha palët e treta të emëruara nga OSHP-ja, për të marrë pjesë në një shqyrtim dhe për të marrë një vendim në një rast të caktuar do të ruajnë të dhënat personale dhe të dhënat që përfaqësojnë shtetin, ushtrinë, sekrete zyrtare apo të afarizmit. Dokumentet dhe instrumentet do të trajtohen në pajtim me klasifikimin e sigurisë siç përcaktohet me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

2. Bordi i OSHP-së, përmes aktit të veçantë të brendshëm, do të përcaktoj masat dhe procedurat për ruajtjen e të dhënave personale dhe të dhënat që përfaqësojnë shtetin, ushtrinë, sekretet zyrtare apo afariste.

Neni 8

Pavarësia, kontaktet e jashtme dhe bashkëpunimi

1. OSHP-ja është një organ i pavarur i krijuar përmes LPP-së. Çdo përpjekje e çfarëdo forme për të ndikuar në OSHP dhe vendimmarrjen e saj është e ndaluar, dhe do të raportohet tek autoritetet kompetente.

2. Të gjitha autoritetet publike obligohen të bashkëpunojnë me OSHP-në në ushtrimin e mandatit të tij shqyrtues në prokurimin publik. Takime të rregullta do të zhvillohen në mes të OSHP-së dhe KRPP-së me qëllim të diskutohet/sigurohet ndër të tjerash, interpretimi konsistent i ligjit të prokurimit publik.

3. Si një organ i pavarur, OSHP-ja mund të krijojë kontakte dhe bashkëpunim lirshëm, përfshirë bashkëpunimin ndërkombëtar dhe pjesëmarrjen aktive në organizatat përkatëse ndërkombëtare të natyrës së saj. Kryetari i OSHP-së (ose personi i autorizuar prej tij) do të përfaqësojë OSHP-në në këto kontakte ose në këto bashkëpunime.

PJESA II

STRUKTURA DHE FUNKSIONET E OSHP-së

Neni 9

Juridiksioni i OSHP-së

OSHP është përgjegjëse për ekzekutimin e funksioneve të përcaktuara në LPP, Ligjin mbi Partneritetin Publiko-Privat, si dhe ligje tjera që mund të bëjnë një rregullim të tillë dhe ankesat në lidhje me këto ligje.

Neni 10

Struktura e OSHP-së

1. OSHP ka strukturën e organizimit të brendshëm si në vijim:

1.1 Bordi i OSHP-së, është i përbërë nga 5 anëtarë, një prej të cilëve është Kryetari;

1.2 Sekretariati i OSHP-së, i cili ofron përkrahje administrative për OSHP-në dhe i përgjigjet Kryetarit të OSHP-së. Sekretariati i OSHP-së kryesohet nga Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP-së, dhe është i strukturuar në njësitë e mëposhtme organizative, të cilat i raportojnë drejtpërsëdrejti Kryesuesit të Sekretariatit të OSHP-së:

1.2.1 Divizioni për Shqyrtimin e Ankesave;

1.2.2 Divizioni i Brendshëm;

1.2.3 Divizioni i Financave;

1.2.4 Sektori ligjor dhe përfaqësues në Gjykata;

1.2.5 Zyra e Burimeve Njerëzore.

2. Organizimi i brendshëm, funksionet dhe përgjegjësitë e vendeve të punës së OSHP-së dhe numri i personave të punësuar (sistematizimi i vendeve të punës), janë përshkruar në detaje me Rregulloren për "Organizimi i Brendshëm dhe Sistematizimi i Vendeve të Punës në Organin Shqyrtues të Prokurimit".

Neni 11

Parandalimi i Konfliktit të Interesit

1. Kryetari i OSHP-së, Anëtarët e Panelit Shqyrtues, Ekspertët Shqyrtues të OSHP-së apo ndonjë staf tjetër i OSHP-së, ose një ekspert apo këshilltar i pavarur, ose ndonjë palë tjetër e tretë, nuk do të jetë i përfshirë në shqyrtimin e një rasti, nëse ai / ajo përballet me një konflikt të interesit të vendosur nga dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksioneve publike, apo legjislacionit tjetër të zbatueshëm në Kosovë.

2. Duke konsideruar ata që janë përmendur më sipër dhe arsyet për përjashtim, personi në fjalë duhet që menjëherë të njoftojë Kryetarin e OSHP-së, i cili do të merr vendim për përjashtim.

3. Përjashtimi i Kryetarit të OSHP-së, do të vendoset në Bordin e OSHP-së, udhëhequr dhe kryesuar nga një Anëtar tjetër në vend të Kryetarit.

4. Secili Anëtar i Panelit Shqyrtues, Ekspert Shqyrtues, ekspert ose këshilltar i pavarur do të nënshkruaj një deklaratë për parandalimin e konfliktit të interesit në momentin e përfshirjes në një rast të një konflikti të interesit, dhe të njoftoj personat kompetent. Për qëllim të këtij neni,

OSHP-ja do të përgatisë një model të deklaratës së tillë. Deklarata do të jepet nën përgjegjësi administrative dhe penale.

PJESA III RREGULLORJA E PUNËS PËR PANELET SHQYRTUESE

Neni 12 Parimet e Përgjithshme për Panelet Shqyrtuese

1. Një procedim i shqyrtimit të një ankese, do të kryhet dhe përfundohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe jo-diskriminuese që është e orientuar drejt arritjes së zgjidhjes së drejtë, ligjore dhe efektive për lëndën e përfshirë. Të gjitha procedimet e shqyrtimit të ankesave do të kryhen në pajtim me dispozitat e aplikueshme të Pjesës IX të LPP-së.
2. Shqyrtimi i ankesave dhe vendimarrja në OSHP nuk do të bëhet në ndonjë mënyrë që diskriminon në favor apo kundër ndonjë pjesëmarrësi në procedime apo ndonjë personi tjetër juridik ose fizik. Parimi i pavarësisë dhe paanësisë në vendimmarrje do të respektohet plotësisht.
3. OSHP do të respektojë natyrën kundërshtuese të procedurës së shqyrtimit. Parimi i kontradiktoritetit të procedurës do të respektohet plotësisht.
4. Të gjitha pjesëmarrësit në procedurëdo të kenë qasje të barabartë në procedimet e shqyrtimit të ankesave dhe mjeteve juridike të vendosura në këtë pjesë.
5. Në marrjen e veprimeve apo masave të ofruara në Pjesën IX të LPP-së, OSHP do të:
 - 5.1 veproj sa më shpejt të jetë e mundshme;
 - 5.2 të veproj në mënyrë që është në proporcion me shkeljen apo çështjet tjera të ankimit dhe;
 - 5.3 merr në konsideratë konsekuencat e mundshme të masave apo veprimeve të tilla, për të gjitha interesat që mund të dëmtohen, përfshirë edhe interesin publik.
6. Një vendim i OSHP-së për të ri-vlerësuar përzgjedhjen e ofertuesve ose dhënien e kontratës nuk do të thotë një ndryshim në rezultatin fillestar.

Neni 13 Dorëzimi i Ankesave

1. Në përputhje me paragrafin 1 të nenit 109 të LPP-së, ankesa pranë OSHP-së mund të

dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes. Fillimisht ankesa do të dorëzohet tek Autoriteti Kontraktues dhe në rast se pala e interesuar nuk është e kënaqur me vendimin e marr nga Autoriteti Kontraktues në fjalë, mund të parashetroj ankesë pranë OSHP-së.

2. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes dhe të dorëzohet brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të LPP-së.

3. Ankesa duhet të dorëzohet e shkruar në njërën nga gjuhët zyrtare, te përcaktuar ne nenin 13 te LPP-se .

4. Ankuesi është i obliguar që të kompletojë dhe dorëzojë ankesën i cila duhet të përfshijë të gjitha të dhënat e kërkuara në formularin standard, siç është publikuar në faqen e internetit të KRPP-se, faqen e OSHP-së dhe platformën e prokurimit elektronik.

5. Ankesa dorëzohet përmes platformës së prokurimit elektronik E-prokurimi,

6. OSHP do të pranoj ankesat edhe në formë fizike vetëm në rastet kur procedurat e prokurimit nuk janë zhvilluar në platformen e e-prokurimit, siç parashihet edhe dorëzimi i ankesës në LPP, ankuesi do të dorëzojë origjinalin e ankesës në OSHP dhe njëkohësisht të dërgojë, me metoda të njëjta apo me postë të zakonshme, një kopje të saj të protokoluar nga OSHP-ja tek autoriteti kontraktues. Ankesat e parashtruara përmes platformës së prokurimit elektronik do t'i dërgohen autoritetit kontraktues në mënyrë automatike kur OSHP-ja i pranon ato zyrtarisht në platformë.

7. Të gjithë ankuesit duhet të paguajnë një tarifë të ankesave në OSHP, konform nenit 14 të F03 të legjislacionit dytësor te KRPP-së në vlerën prej:

7.1 Kurdo që ankesa ndërlidhet me vendimin për shpërbllim të një kontrate, shuma e tarifës së ankesës është e barabartë me një përqind (1%) të vlerës së ofertës, por jo më pak se 100 Euro dhe jo më shumë se 5,000 Euro.

7.2 Kurdo që ankesa ndërlidhet me njoftimin për kontratë, dokumentet e tenderit, shuma e tarifës së ankesës është e barabartë me një përqind (1%) të vlerës së parashikuar, por jo më pak se 100 Euro dhe jo më shumë se 5,000 Euro.

8. Paguesa do të bëhet në llogarinë e krijuar nga OSHP-ja. Fatura për pagesën e tarifës mund të merren në zyrat e OSHP-së, si dhe në platformën e prokurimit elektronik.

9. Ankesa duhet të jetë e qartë, e shkurtër dhe me pretendimet e supozuara, që eventualisht janë shkelur nenet e caktuara të LPP-së, nga ana e autoritetit kontraktues. Pretendimet ankimore duhet të jenë të njëjta me ato të paraqitura për autoritetin kontraktues.

10. OSHP-ja, kërkon nga autoritetet kontraktuese të dorëzojë tërë pakon e dokumenteve, që kanë të bëjnë me ankesën e caktuar në afat prej 3 ditësh.

11. Kur dokumentacioni i përmendur në paragrafin 10 të këtij neni është në dispozicion në platformën e prokurimit elektronik, OSHP do t'u qaset këtij dokumentacioni përmes platformës së e-prokurimit.

Neni 14 **Përmbajtja e Ankesës**

1. Në përputhje me nenin 111 paragrafi 1 të LPP-së, një ankesë duhet që të përfshijë të paktën informatat si në vijim:

- 1.1 Informatat e ankuesit: emri, emri i kompanisë, adresa dhe informatat kontaktuese; informatat e përfaqësuesit apo agjentit me kompetencën e përfaqësuesit ligjor;
- 1.2 përmban emrin e Autoritetit përkatës Kontraktues;
- 1.3 një përshkrim i arsyeshëm i aktivitetit të prokurimit në fjalë;
- 1.4 e ka të bashkangjitur një kopje të njoftimit për dhënien e kontratës ose të njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit, nëse diç e tillë është nxjerrë ose publikuar;
- 1.5 një demonstrim që apeluesi kualifikohet si “palë e interesuar” siç është e përkufizuar sipas Nenit 4 pika 1.26 të LPP-së;
- 1.6 një përshkrim i shkeljeve të supozuara të LPP-së apo legjislacioni tjetër dhe gjithashtu paraqet shpjegim se si ka ndodhur kjo shkelje dhe paraqet provat;
- 1.7 një përshkrim se si shkelja e supozuar ka shkaktuar apo kërcënon të shkaktoj dëme

materiale të ankuesi në raste kur ankuesi përfshinë kërkesë për kompensim;

- 1.8 e ka të bashkangjitur një kopje të vendimit të miratuar nga Autoriteti Kontraktues gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të LPP; dhe siguron dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit, të përmendur në nenin 118 të LPP.
- 1.9 deklarata e pretendimeve/kërkesa për zgjidhje;
- 1.10 kërkesa për kompensim të kostove procedurale;
- 1.11 nënshkrimi i personit të autorizuar dhe vula, kur ankesa është dërguar në formën fizike ose përmes postës.

Neni 15 Regjistrimi i Ankesave

1. Ankesa duhet të regjistrohet nga zyrtari për ankesa. Për ankesat e paraqitura përmes platformës së prokurimit elektronik, konfirmimi i pranimit të ankesës do të gjenerohet automatikisht kur zyrtari për ankesa e pranon ankesën në kuadër të platformës së prokurimit elektronik në përputhje me Nenin 17 të kësaj Rregulloreje.
2. Të gjitha ankesat e regjistruara do të publikohen në faqen e internetit të OSHP-së, menjëherë pas regjistrimit.

Neni 16 Rastet e Unifikuara

1. Kryetari i OSHP-së, mund të vendosë që ti bashkoj rastet të cilat janë të lidhura me lëndën e njëjtë apo tenderin e njëjtë, dhe për këto raste mund të merren vendime nga paneli i njëjtë shqyrtues dhe eksperti i njëjtë shqyrtues, në përjashtim të rasteve të përcaktuara në nenin 22 të kësaj rregulloreje.
2. Eksperti i njëjtë shqyrtues, teknik ose profesional i prokurimit, nëse konstaton se pretendimet ankimore janë të njëjta të cilat janë shqyrtuar më parë nga paneli shqyrtues, e njofton me shkrim panelin shqyrtues dhe palet në procedurë lidhur me këto pretendime ankimore.
3. Në rastet e përsëritura me pretendime të njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për rastet të cilat janë shqyrtuar më parë, paneli shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar “res judicata”, në kuptim të nenit 105.2.16 të LPP-së.

Neni 17

Shqyrtimi paraprak i Ankesës dhe Përcaktimi i Ekspertit Shqyrtues

1. Zyrtari për pranim të ankesave, do të kontrolloj ankesën menjëherë për të përcaktuar nëse i takon juridiksionit të OSHP-së dhe përmban informatat e kërkuara sipas nenit 14 të kësaj rregulloreje.
2. Zyrtari për pranim të ankesave do të kompletoj një shqyrtim të tillë brenda një (1) ditë pas pranimit të ankesës.
3. Nëse ankesa nuk bie nën juridiksionin e OSHP-së apo është e jashtë afatshme sipas ligjit, atëherë do të njoftohet Kryesuesi i Sekretariatit, që ta refuzoj apo ta hedhë poshtë si të jashtë afatshme ankesën. Kjo përfshinë edhe ankesat në lidhje me entitetet të cilat nuk janë autoritete kontraktuese apo kontratat që nuk përfshihen në LPP.
4. Të gjitha rastet e refuzimeve do të bëhen me shkrim dhe do të arsyetohen.
5. Nëse ankesa nuk është e kompletuar dhe nuk i përmbush kërkesat e mësipërme, në përputhje me nenin 14 të rregullores, atëherë zyrtari për pranimin e ankesave do të informoj dorëzuesin për mangësitë sa më shpejt të jetë e mundur (përmes postës elektronike) ose platformës së e-prokurimit. Nëse afati i dorëzimit ka skaduar apo do të skadojë brenda jo më pak se katër (4) ditë pune, ankuesit do t'i lejohen katër (4) ditë pune për të korrigjuar ankesën dhe për të dorëzuar prapë (me të gjitha kopjet e bashkangjitura). Nëse afati i dorëzimit nuk ka skaduar apo nuk do të skadojë brenda dy (2) ditë, ankuesi mundë të ri-dorëzojë ankesën në çdo kohë para se të skadojë afati i paraparë.
6. Nëse pas ri-dorëzimit, ankesa ka mangësi, atëherë Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP-së, do ta hedhë poshtë si të pa-lejuar ankesën dhe nuk do të jetë e mundshme që të ri-dorëzohet prapë edhe nëse bëhen përmirësime.
7. Nëse konstatohet që ankesa i takon juridiksionit të OSHP-së, është e kompletuar dhe është dorëzuar me kohë, siç përcaktohet sipas LPP-së, autoriteti kontraktues është i obliguar që automatikisht ta pezulloj aktivitetin e prokurimit me të cilin ka të bëjë ankesa pa ndonjë njoftim nga OSHP-ja konform nenin 112.1 të LPP-së.
8. Një panel shqyrtues do të formohet pasi një ankesë është pranuar për shqyrtim në mënyrë që të shqyrtohen pretendimet ankimore.

9. Çdo rast do t'i përcaktohet një anëtari të Bordit të OSHP-së, i cili do të jetë Kryetari apo anëtari i vetëm i panelit shqyrtues të krijuar, dhe do të jetë përgjegjës për rastin ("anëtari i përcaktuar i OSHP-së"). Rastet do të caktohen, sipas rëndësisë, kompleksitetit dhe ngarkesave në punë.

10. Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP-së do të përcaktoj menjëherë rastin tek një ekspert shqyrtues, teknik apo ekspert profesional të prokurimit.

11. Eksperti shqyrtues apo profesional, do të bëjë një kërkesë me shkrim, përmes shkresës elektronike apo kopje fizike, nëse çështja duhet të trajtohet edhe nga një ekspert teknik. Kjo kërkesë duhet të bëhet jo më vonë se dy (2) ditë pas pranimit të autorizimit për shqyrtim.

12. Nëse bëhet një rekomandim për caktimin e një eksperti teknik, Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP-së do të vendosë, dhe do të përzgjedh një ekspert të jashtëm nga "Regjistri i Ekspertëve Teknik" të OSHP-së nëse një ekspert i tillë të një lëmie specifike mungon në listën përkatëse, mundet të caktoj një ekspert edhe pse nuk është i përfshirë në listë.

13. OSHP bën shpalljen e njoftimit në uebfaqen e OSHP-së për listimin e ekspertëve teknik dhe profesional në listën e ekspertëve shqyrtues. Njoftimi përmban kriteret e përzgjedhjes, dhe përzgjedhja e ekspertëve që iu kanë përgjigjur njoftimit bëhet pas vlerësimit të komisionit vlerësues i cili themelohet me vendim të Sekretariatit.

Neni 18

Pezullimi dhe heqja e pezullimit automatik

1. Parashtrimi i ankesës së plotë brenda afatit kohor dhe brenda juridiksionit të OSHP-së, pezullon aktivitetin e prokurimit. Heqja ose pezullimi i tillë kërkon përmbushjen e kushteve nga neni 112 të LPP-së.

Neni 19

Raporti i Ekspertit shqyrtues të OSHP-së

1. Eksperti i OSHP-së, të cilit i është përcaktuar rasti sipas nenit 17 të kësaj rregulloreje, brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike pas pranimit të autorizimit për shqyrtim, në përputhje me nenin 114 të LPP-së është i obliguar t'i shqyrtojë të gjitha pretendimet ankimore të përfshira në ankesë dhe nëse ka pretendime të cilat nuk i ka parashtuar në kërkesën për rishqyrtim pranë autoritetit kontraktues, atëherë eksperti shqyrtues obligohet që në raport të ekspertizës të bëjë ndarjen e

pretendimeve për panelin shqyrtues.

2. Vlerësimi dhe rekomandimet duhet të sigurohet duke përdorur modelin standard të bashkëngjitur kësaj rregulloreje si shtojca A. Çdo mbledhje dhe ruajtje e informacionit shtesë të kërkuar për vlerësim duhet të përpunohet me anë të modelit të tabelës për mbledhje të dëshmive, të bashkëngjitur kësaj rregulloreje si shtojca B. Së bashku, shtojca A dhe B e përbëjnë raportin e ekspertit shqyrtues.

3. Raporti i ekspertit shqyrtues do të jetë pa paragjykim ndaj vendimit përfundimtar të panelit shqyrtues mbi rastin. Raporti i ekspertit shqyrtues pas protokollimi nga ana e arkivës së OSHP-së do të dërgohet tek autoriteti kontraktues, ankuesi dhe paneli shqyrtues. Raporti i ekspertit shqyrtues do të ngarkohet dhe dërgohet përmes platformës së prokurimit elektronik, kur platforma e-prokurimit është e aplikueshme.

4. Në rast se autoriteti kontraktues dhe parashtruesi i ankesës pajtohen me raportin e ekspertit shqyrtues, paneli shqyrtues nxjerrë njoftim që autoriteti kontraktues, në afat prej 5 ditësh ta implementojë raportin e ekspertit shqyrtues duke i njoftuar palët në procedurë.

Neni 20

Procedura dhe kompetencat e Autoritetit Kontraktues në lidhje me ankesën

1. Autoriteti Kontraktues do t'i përgjigjet mendimit të ekspertit shqyrtues brenda katër (4) ditë, përmes një parashtrëse me shkrim, dhe parashtrësa t'i dërgohet OSHP-së dhe të gjitha palëve në procedurë, konform nenit 115 të LPP-së. Kur një informacion i tillë është i qasshëm në platformën e prokurimit elektronik, OSHP-ja dhe palët në procedurë do t'i qasen atyre informatave drejtpërdrejtë.

2. Të gjitha dokumentet, informatat dhe njoftimet duhet të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së prokurimit elektronik nëse është teknikisht e mundur.

Neni 21

Përbërja e Paneleve Shqyrtuese

1. Paneli shqyrtues duhet të themelohet pas pranimit të ankesës konform nenit 17 të kësaj rregulloreje.

2. Panelet shqyrtuese përbëhen nga një (1), tre (3) ose pesë (5) anëtarë të Bordit të OSHP-së.

3. Kryetari i OSHP-së, me rastin e caktimit të paneleve shqyrtuese (PSH), gjithashtu cakton:

3.1 Kryetarin e PSH, referuesin e PSH si dhe anëtarët e PSH;

3.2 Referuesi i çështjes, përgatit një informacion të detajuar mbi rastin dhe të njëjtin ja paraqet PSH.

4. Kryetari i OSHP-së, emëron panelin prej një anëtari, për këto raste:

4.1 Kur vlera e lëndës së ankesës për aktivitetin e prokurimit nuk e tejkalon shumën prej 30.000,00 € (tridhjetë mijë euro).

5. Kryetari emëron panelin prej tre anëtarëve, për këto raste:

5.1 Kur kemi të bëjmë në vlerësimin e kriterëve diskriminuese gjatë fazës së tenderimit, ose

5.2 Kur vlera e lëndës së ankesës për aktivitetin e prokurimit është mbi 30.000.00€ (tridhjetë mijë euro) dhe jo më e madhe se 500.000,00 €(pesëqind mijë euro).

6. Kryetari emëron panelin prej pesë anëtarëve, për këto raste:

6.1 Kur vlera e lëndës së ankesës për aktivitetin e prokurimit është mbi 500,000.00 € (pesëqind mijë euro), ose

6.2 Kur rasti është me ndonjë rëndësi dhe interes të veçantë .

7. Nëse ndonjë anëtar i Panelit Shqyrtues në pamundësi të marrjes pjesë në Panel Shqyrtues, atëherë Kryetari i OSHP-së do të caktojë një anëtar tjetër.

8. Në raste kur vlera e procedurës së prokurimit tejkalon 500.000,00 Euro (pesëqind mijë euro), por për arsytet e mësipërme një panel pesë-anëtarësh nuk mund të emërohet, atëherë Kryetari ka autoritetin të ndryshoj Panelin Shqyrtues, prej pesë anëtarësh në një Panel Shqyrtues prej tre anëtarësh.

9. Kryetari i Panelit Shqyrtues do të nënshkruaj të gjitha dokumentet e prodhuara nga Paneli Shqyrtues i përcaktuar në rastin konkret.

Neni 22
Nxjerrja e Urdhrit për Hetim nga Panelet Shqyrtuese

1. Paneli shqyrtues mund të urdhërojë çdo person, ndërmarrje ose autoritet publik, duke kërkuar nga i njëjti person, ndërmarrje ose autoritet të prodhojë, transferojë, dërgoj dhe / ose të lejojë qasje në të dhëna, informacion, dokumente (përveç këshillave juridike të privileguara), dhe / ose të tjera sende nga pasuria e luajtshme dhe / ose e paluajtshme që paneli shqyrtues në ushtrimin e diskrecionit të arsyeshëm, i konsideron të rëndësishme për të kryer shqyrtimi e një procedure të prokurimit.
2. Paneli shqyrtues mund të kërkojë me urdhër çdo personi të paraqitet në procesin e shqyrtimit të prokurimit të panelit shqyrtues dhe të ofrojnë dëshmi në lidhje me çdo gjë që paneli shqyrtues konsideron që janë të nevojshme për marrjen e një vendimi të drejtë, nën ushtrimin e lejes së arsyeshme, dhe të jetë relevante lidhur me lëndën e prokurimit.
3. Një panel shqyrtues ka të drejtë të ndërmerr veprime tjera të nevojshme dhe të duhura për të verifikuar argumentet apo pretendimet e palëve.
4. Paneli shqyrtues mund të kërkojë me një urdhër informacion shtesë, i cili mund të përfshijë dërgimin e materialit, provave nga çdo person, kompani ose autoritet publike të cilit paneli shqyrtues, me arsye beson se mund të jetë i rëndësishëm për rastin dhe mund të përfshijë provat nga personat e tillë.

Neni 23
Nxjerrja e Urdhëresës së Zgjidhjes dhe Vendimeve nga Panelet Shqyrtuese

1. Një panel shqyrtues që ekzaminon një ankesë ka kompetencën, autoritetin, fuqinë dhe përgjegjësinë, nën kushte të specifikuar në LPP, të lëshojë urdhëresa të ndryshme të zgjidhjes dhe vendimeve.
2. Paneli shqyrtues mund t'i jap urdhër autoritetit kontraktues, deri më tani të lejuar nga LPP, duke e detyruar autoritetin e tillë që të suspendojë ose përfundoj zbatimin e aktivitetit të prokurimit ose zbatimin e vendimit të autoritetit të tillë lidhur me ose gjatë aktivitetit në fjalë.
3. Paneli shqyrtues mund të nxjerrë një urdhër, aq sa lejohet në LPP, për një autoritet kontraktues që kërkon nga ai autoritet që të anuloj apo revokojë një vendim të autoritetit të tillë të cilin mund të ketë marrë gjatë aktivitetit të prokurimit, përfshirë kushte dhe specifikime që nuk janë në përputhje me ligjin në dosjen e tenderit.
4. Paneli shqyrtues mund të nxjerrë një urdhër për autoritetin kontraktues që kërkon nga ai

autoritet të paguaj kompensim për një ankues.

5. Paneli Shqyrtues mund të nxjerrë një urdhër për Autoritetin Kontraktues që kërkon nga ai autoritet të korrigjoj një shkelje të supozuar dhe/ose të parandaloi dëme të mëtutjeshme ndaj apeluesit dhe/ose një pale tjetër të interesuar.

6. Paneli shqyrtues mund të nxjerrë një urdhër për autoritetin kontraktues që kërkon nga ai autoritet të heq specifikime, kërkesa apo kritere teknike, ekonomike, financiare ose përzgjedhëse të cilat janë diskriminuese, në ndonjë shpallje, ftesë, dosje të tenderit, dokument të kontratës ose dokument tjetër lidhur me një aktivitet të prokurimit.

7. Paneli shqyrtues mund të nxjerrë një urdhër që kërkon nga zyrtarët e zbatimit të ligjit që të asistojnë OSHP-në në sigurimin e përfilljes së një urdhri të OSHP-së.

8. Paneli Shqyrtues mund të nxjerrë një urdhër që e bënë një kontratë të nënshkruar jo- efektive, nëse është lidhur pa publikim paraprak në pajtim me nenin 42 të LPP-së, apo nëse nënshkrimi i kontratës është bërë para skadimit të afatit kohor të cekur në nën-paragrafin 1 të paragrafit 4 neni 26 të LPP-së.

9. Paneli Shqyrtues mund të vendosë ndëshkime për çdo autoritet kontraktues i cili përkundër nxjerrjes së një urdhri sipas nën-paragrafit 2.13 të nenit 105 të LPP-së, vazhdon të mbikëqyrë apo të implementoj kontratën që i nënshtrohet një urdhri të tillë.

10. Paneli Shqyrtues ka autoritetin që të adresoj çdo refuzim apo mungesë të bashkëpunimit nga ndonjë palë dhe të vendosë në favor të palës së kundërt, me kusht që një vendim i tillë është i justifikueshëm.

11. Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, Paneli Shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar "*Res judicata*". Në mënyrë që një ankesë të trajtohet si "*Res judicata*", siç është përcaktuar në këtë nen, kushtet e mëposhtme duhet të plotësohen:

11.1. Rastet e përsëritura;

11.2. Pretendimet e njëjta;

11.3. Objekti i kontestit është i njëjtë; dhe

11.4. Palët janë të njëjta;

Neni 24 **Procedura e Dëgjimit të Hapur**

1. Paneli shqyrtues kryesisht vendos në seancë pa prezencë të palëve.
2. Paneli shqyrtues mundet në raste të veçanta, për të sqaruar fakte komplekse-teknike në lidhje me objektin e ankesës, të caktojë seance dëgjimore me pjesëmarrjen e palëve në procedurë të cilat kanë interes juridik dhe material.
3. Operatorët ekonomikë në seanca dëgjimore mund të përfaqësohen konform ligjit të përgjithshëm të procedurës administrative.
4. Autoritetet kontraktuese në seanca dëgjimore mund të përfaqësohen nga personat e autorizuar nga ZKA.
5. Data dhe koha e dëgjimit do të definohen dhe komunikohen te palët të paktën dy (2) ditë kalendarike paraprakisht. Secila palë ka të drejtë të kërkojë shtyrjen e dëgjimit me justifikim të bazuar me kusht që kjo do të ndodhë vetëm një herë, ndërsa shtyrja nuk mund të jetë më shumë se pesë (5) ditë kalendarike.
6. Zhvillimi i një seance dëgjimore do të regjistrohet me procesverbal dhe do të nënshkruhet nga të gjithë pjesëmarrësit. Seancat dëgjimore për shqyrtim kryesor mund të mbahen me video-incipime të inicuar nga paneli shqyrtues.
7. Seancën dëgjimore e drejton kryesuesi i panelit shqyrtues në bashkëpunim me anëtarët e panelit shqyrtues. Pjesëmarrësit në seancë dëgjimore mund të diskutojnë vetëm për objektin e shqyrtimit dhe vetëm atëher kur iu jepet fjala nga ana e kryetarit të panelit shqyrtues. Nëse ndonjë nga pjesëmarrësit në seancë dëgjimore tenton të abuzoj me autorizimin e tij, kryesuesi i seancës do të ja tërheq vërejtjen me gojë, e nëse i njëjti nuk zbaton vërejtjen gojore, atëherë kryesuesi së bashku me anëtarët e panelit do t'i japin vërejtje me shkrim dhe mund ta përjashtojnë/largojnë nga seanca dhe t'i shqiptojnë gjobë nga 100Euro deri 500Euro.

Neni 25 **Ekspertët Shqyrtues, Ekspertët Profesional të Prokurimit dhe Ekspertët e Jashtëm Teknik**

1. Një panel shqyrtues mund të kërkojë prezencën dhe dëshminë gjatë një shqyrtimit të një eksperti shqyrtues, një eksperti profesional të prokurimit i cili ka trajtuar rastin apo një ekspert

tekniki jashtëm.

2. Çdo ekspert i emëruar do të jetë i përfshirë në divizionin për shqyrtim të ankesave, regjistrin e ekspertëve profesional të prokurimit apo regjistrin e ekspertëve teknikë OSHP-së.
3. Sekretariati në baza të rregullta vjetore do të përditësoj regjistrin e ekspertëve profesional dhe teknik.
4. Në raste specifike, kur nevojitet një njohuri e specializuar, dhe regjisti i ekspertëve teknik nuk e disponojnë njohurinë e specialuzar të kërkuar për shqyrtimin e ankesës, atëherë Sekretariati rezervon të drejtën të emëroj një ekspert teknik jashtë regjistrit në baza *ad hoc*.

Neni 26

Diskutimet e Panelit dhe minutat

1. Eksperti i OSHP-së i caktuar nga OSHP, do të bëjë një përmbledhje të rastit gjatë seancës dëgjimore, dhe pastaj çdo anëtar i panelit shqyrtues do të ketë mundësinë të diskutoj apo të parashtojë pyetje për palët në procedure.
2. Votimi duhet të bëhet me shumicë të thjeshtë dhe asnjë anëtar i panelit shqyrtues nuk mund të abstenoj nga votimi. Votimi duhet të bëhet menjëherë pas seancës dëgjimore në seancën për këshillim dhe votim.
3. Në raste specifike, me qëllim të vërtetimit të provave dhe fakteve të paraqitura gjatë seancës dëgjimore, paneli shqyrtues mund të shtyjë seancën për këshillim dhe votim për kohë të pacaktuar por me kusht që të respektohen afatet ligjore të përcaktuara në LPP për marrjen e vendimeve.
4. Pas seancës për këshillim dhe votim, Kryetari i Panelit Shqyrtues duhet që t'i pajisë palët në procedurë me vendim të panelit Shqyrtues.
5. Veprimet e ndërmarra në takimet e panelit shqyrtues, në të cilin lënda e një mospajtimi të caktuar diskutohet, do të regjistrohen me procesverbal. Diskutimet në të ardhmen mund të incizohen me video dhe audio-incizim.
6. Në procesverbal të seancës dëgjimore përfshihet emri i institucionit, anëtarëve të panelit shqyrtues, datën dhe kohën kur vendimi është ndërmarrë, titulli i lëndës së shqyrtimit në procedurë dhe informata për palët pjesëmarrëse dhe përfaqësuesit e tyre.

7. Procesverbali do të nënshkruhet nga Kryetari i Panelit Shqyrtues, palët pjesëmarrëse ose përfaqësuesit e tyre dhe procesmbajtësi që ka regjistruar procesverbalin. Procesverbali do të jetë pjesë integrale e dosjes së rastit.

8. Rezultati i votimit mund të publikohet; megjithatë, vota e secilit anëtar është plotësisht konfidenciale.

Neni 27 **Kufizimet për vendime të OSHP-së**

1. OSHP-ja do të nxjerrë vendime, konkluzion, njoftim dhe urdhra ("Vendime") brenda pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike, si në vijim:

1.1 skadimit të afatit prej tre (3) ditëve të përcaktuara në nenin 115.7 të LPP-së, për Autoritetin Kontraktues për të transferuar të gjitha dokumentet dhe shënimet lidhur me aktivitetin përkatës të prokurimit. Kjo, me kusht që Autoriteti Kontraktues ka marrë një kopje të një njoftimi me shkrim nga parashtruesi i ankesës në OSHP, në lidhje me dështimin e autoritetit kontraktues për të marrë masat e duhura korrigjuese brenda afatit prej pesë (5) ditëve të përcaktuara në nenin 115.3 të LPP-së;

1.2 dorëzimin e të dhënave shtesë dhe / ose shpjegime kërkuar nga OSHP-ja, sipas pikës 3 të nenit 116 të LPP-së, ose nga ankuesi ose Autoriteti Kontraktues dhe të lejuar nga OSHP-ja sipas paragrafit 4 të nenit të njëjtë.

2. Paneli shqyrtues në raste të ndërlikuara, mund të shtyjë afatin për shqyrtim jo me shumë se 20 ditë tjera kalendarike.

Neni 28 **Tërheqja e ankesës**

1. Pala mund ta tërheqë ankesën në çdo kohë. Në rast se ankesa tërhiqet para shqyrtimit të ankesës dhe/ose emërimit të ekspertit shqyrtues dhe para pranimit të akt-ekspertizës, do të bëhet kthimi i tarifës së ankesës. Në qoftë se ankuesi e tërheq ankesën pas emërimit të ekspertit shqyrtues dhe pranimit të akt-ekspertizës atëherë bëhet konfiskimi i tarifës në emër të shpenzimeve procedurale.

2. Në rast së parashtruesi i ankesës e tërheq ankesën, pa arsye të justifikuara, atëherë atij nuk do t'i kthehet tarifa për ankesë.

Neni 29

Përmbajtja e vendimeve

1. Vendimet do të përmbajnë: (1) hyrjen, dispozitivin dhe arsyetimi i cili bëhet konform shtojcës C të kësaj rregullore, dhe këshillën juridike, (2) çdo urdhër i dhënë, përfshirë dëmet, por pa u kufizuar vetëm në to, anulimi, nënshkrimi i kontratës, procedura e ndjekur e prokurimit, (3) nëse ka pasur dëme dhe nëse po, në çfarë mase (4) dispozitivin në lidhje me kthimin ose konfiskimin e tarifës për ankesë.
2. OSHP-ja gjatë shqyrtimit të një ankese rezervon të drejtën në çdo kohë të kërkojë sqarime shtesë nga palët procedurale në çdo kohë para nxjerrjes së vendimit merititor.
3. Autoriteti kontraktues detyrohet që në afat prej 10 ditësh ta zbatojë vendimin e panelit shqyrtues konform nenit 105 të LPP-së. Kur vendimi i panelit shqyrtues është për ri-vlerësim të aktivitetit të prokurimit, atëherë obligohet autoriteti kontraktues që brenda 15 (pesëmbëdhjetë) dite nga dita e pranimit të vendimit, të njoftojë OSHP-në, lidhur me rezultatin e procesit të ri-vlerësimit dhe njëkohësisht t'i njoftojë palët në procedurë.
4. Numri i referencës për rastin dhe për prokurimin e shqyrtuar duhet të paraqitet në vendim. Vendimi mund të lëshohet në gjuhën shqipe apo gjuhën serbe.
5. Vendimi duhet t'u lëshohet të gjitha palëve, ndërsa një formë origjinale e tij duhet të mbetet në regjistrin dhe arkivin e OSHP-së. Vendimi do të komunikohet përmes platformës së prokurimit elektronik për të gjitha palët kur është e aplikueshme.

Neni 30

Dëmet me kompensimin e shpenzimeve procedurale

1. Një palë e procedurës së shqyrtimit, mund të kërkojë kompensimin e shpenzimeve procedurale, të cilat do të përfshijnë tarifën e ankesës dhe shpenzimet rrjedhëse për të përgatitur ankesën dhe për përgjigje të kërkesave të Ekspertit Shqyrtues apo Panelit Shqyrtues.
2. Kostot mund të mbulohen për palën e suksesshme. Kostot do të jenë si në vijim:
 - 3.1 përgatitja e ankesës duke përfshirë shpenzimin e transaksionit - nga 250,00 EURO për rastet nën 100,000,00 EUR deri në 350,00 EURO për rastet mbi 100.000,00 EURO.

3.2 kostot e marrjes dhe dorëzimit të tarifës së ankesës (normën e interesit për sigurim dhe kohëzgjatjen e tarifës në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës).

3.3 pala humbëse mund të paguan kostot e ekspertizës financiare e cila e bën vlerësimin e dëmeve të shkaktuara, nëse vendosë OSHP-ja.

Neni 31

Kthimi i tarifës për ankesë pas vlerësimit të ankesës

1. Si pjesë e vendimit të Panelit Shqyrtues, Paneli Shqyrtues duhet të vlerësojë, nëse ankesa është me apo pa bazë. Paneli Shqyrtues duhet të përcaktojë se pretendimi është i pa bazë, nëse vjen në përfundim se ankuesi, në kohën kur është parashtruar ankesa, e ka ditur apo është dashur ta dijë se nuk kishte mbështetje objektive në fakte, apo nuk kishte mbështetje të arsyeshme në ligj për një pohim të tillë.

2. Në veçanti dhe pa asnjë kufizim, Paneli Shqyrtues duhet ta konsiderojë ankesën të pa bazë nëse, edhe po të mos kishte shkelje të ligjit, ankuesi nuk do të kishte gjasa për fitimin e tenderit. Prandaj ankuesi nuk ka pësuar kurrfarë humbjeje, por është përpjekur që ta anulojë tenderin, për t'i dhënë vetes mundësi t'i ndryshojë çmimet apo kushtet e ofertës në një mënyrë që është e pandershme ndaj tenderuesve të tjerë, do të vlerësohet si e pa bazë.

3. Në raste të tilla, OSHP-ja, duhet ta njoftojë me shkrim ankuesin pa vonesë, për përcaktimin e vet dhe para se ta bëjë këtë, duhet të ndër marrë aso masash që janë të përshtatshme për të imponuar fondet e sigurimit, ndërsa tarifa për ankesë duhet të konsiderohen si fonde të konfiskuara.

4. Nëse OSHP konstaton se ankesa ka qenë e bazuar, ose ankuesi tërheq ankesën, apo nëse OSHP shpallet inkompetente për trajtimin ankesës në fjalë, si dhe nëse ankesa është jo e plotë, si dhe nëse ankesa është e jashtë afatshme, atëherë ankuesit duhet t'i kthehet tarifa e sigurimit të ankesës, sipas nenit 13 paragrafi 7 të kësaj Rregulloreje të punës.

5. Konfiskimi i tarifës për sigurim të ankesës, do të zbatohet edhe në ato raste kur paneli shqyrtues e hedh poshtë ankesën si të palejuar, kur konstatohet se ankuesi ka qenë i papërgjegjshëm dhe kurë vërehet qartë se qëllimi i ankuesit është prolongimi i aktivitetit të prokurimit.

6. Në rastin kur ankuesit i aprovohet ankesa si e bazuar, ose tërhiqet nga ankesa, atëherë ankuesi, në afat prej 60 ditëve duhet të bëjë kërkesë për tërheqje të depozitës në vlerën prej sipas nenit 13 paragrafi 7 të Rregullores së punës për sigurimin e ankesës. Nëse ankuesi nuk bën

kërkesë brenda këtij afati kohor prej 60 ditësh, i bëhet konfiskimi i depozitës për sigurimin e ankesës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

7. Nëse OSHP konstaton se cilado nga pretendimet e bëra në ankesë janë të rrejshme, atëherë OSHP-ja, mund të kërkojë nga parashtruesi i ankesës që të paguajë një gjobë shtesë deri në 5.000,00 EUR.

8. Nëse OSHP aplikon një gjobë në bazë të paragrafit 4 të nenit 118 të LPP-së, një urdhër do të lëshohet për ankuesin që të paguaj tarifën, dhe ankuesi do të informohet që deri sa tarifa nuk paguhet në tërësi apo gjykata kompetente shfuqizon vendimin e OSHP-së, ankuesi nuk do të mund të marrë pjesë në asnjë aktivitet të prokurimit të paraparë sipas ligjit.

Neni 32

Diskualifikimi i operatoreve ekonomike

1. OSHP është e obliguar dhe ka autoritetin që të shqyrtojë dhe të diskualifikojë operatorin ekonomik nga pjesëmarrja në prokurim publik. Kur OSHP me kërkesë nga një autoritet kontraktues, inicion një shqyrtim lidhur me informata të rremë ose dokumente të falsifikuara, siç përmendet në nenin 99 (2) të LPP-së, ajo duhet t'i sigurojë operatorit ekonomik të drejtën për t'u dëgjuar duke përfshirë edhe garancitë ligjore të përmendura në nenin 107 të LPP-se.

2. Nëse diskualifikimi aprovohet sipas kërkesës së autoritetit kontraktues, atëherë operatori ekonomik i diskualifikuar nuk mund të marr pjesë në asnjë aktivitet të prokurimit që përfshin aktivitetet e prokurimit aktuale dhe të ardhshme. Diskualifikimi është i vlefshëm nga momenti i nxjerrës së vendimit lidhur me diskualifikimin, deri në periudhën kohore të përcaktuar në vendim të panelit shqyrtues. Për qëllime të kësaj dispozite aktiviteti i prokurimit ndër të tjerash përfshin dhe nënshkrimin e kontratës publike me autoritetin kontraktues.

Neni 33

Zbatimi i vendimeve të Paneleve Shqyrtuese

Të gjitha autoritetet kontraktuese do të informojnë OSHP-në për zbatimin e vendimeve të paneleve shqyrtuese. Sekretariati do të ndjekë zbatimin e vendimeve të paneleve shqyrtuese, dhe nëse është e nevojshme mund të kërkojë informacion shtesë për zbatimin e vendimeve të paneleve shqyrtuese.

Neni 34

Vula zyrtare e OSHP-së

1. OSHP-ja duhet të këtë një vulë të lejuar katrore dhe të rrumbullakët “Organi Shqyrtues i Prokurimit”, në gjuhën Shqipe dhe Serbe.
2. Vula e rrumbullaket ka madhësinë 3.9 cm, në mes të vulës ekziston emblema e OSHP-së dhe teksti me këtë përmbajtje: Republika e Kosovës, Organi Shqyrtues i Prokurimi - Prishtinë dhe atë në dy gjuhë, në gjuhën Shqipe dhe atë Serbe.
3. Vula katrore e cila ka madhësinë 6.9 X 3.7 cm në të cilën është e vendosur stema e Republikës së Kosovës dhe emblema e Organit Shqyrtues të Prokurimit, me përmbajtje Republika e Kosovës, Organi Shqyrtues i Prokurimit - Prishtinë, numri dhe data, dy gjuhët Shqipe dhe Serbe.

Neni 35

Politikat mbi qasjen në dokumente

1. OSHP-ja mund t’i ruajë informatat e krijuara gjatë kryerjes së punës së saj dhe mos t’i perhap informatat e tilla për publikun apo personat e paautorizuar deri në shkallën e lejuar sipas LPP-së, dhe Ligjit për Qasje në Dokumentet Zyrtare.
2. OSHP-ja do të bashkëpunojë plotësisht me Auditorin Gjeneral apo gjykatën e juridiksionit kompetent.

Neni 36

Raportimi në Kuvendin e Republikës së Kosovës

1. OSHP-ja duhet të sigurojnë një raport vjetor mbi punën e saj për Kuvendin e Republikës Kosovës, jo më vonë se deri në fund të muajit shkurt, në lidhje me vitin paraprak kalendarik. Raporti vjetor do të përfshijë të dhënat dhe analizat e mbrojtjes ligjore në sistemin e prokurimit publik, si dhe ankesat e parashtruara nga operatorët ekonomik ankues kundër vendimit të autoriteteve kontraktuese për dhënie të kontratës dhe kundër njoftimit për kontratë.
2. Raporti do të përmbajë informata në vijim:
 - 2.1 numrin e përgjithshëm të ankesave të pranuar;
 - 2.2 numrin e ankesave të refuzuara, jo të plota dhe të jashtë afatëshme sipas nenit 109 dhe nenit 111 të LPP-se, ose dështimit për të depozituar tarifën për ankesa, të kërkuar në nenin 118 të LPP-së, si dhe numrin e ankesave të tërhequra;

- 2.3 numrin e ankesave që janë konstatuar se nuk përmbajnë pretendime të vlefshme;
- 2.4 numrin e aktiviteteve të prokurimit që janë anuluar si rezultat i një ankese;
- 2.5 informacione të hollësishme për çdo rast kur Autoriteti Kontraktues nuk e ka respektuar një urdhër të OSHP-së ose një paneli shqyrtues;
- 2.6 numrin e procedurave të shqyrtimit që kanë rezultuar në konstatimin se aktiviteti përkatës i prokurimit dhe dhënia ose vendimi janë bërë në mënyrë të vlefshme;
- 2.7 raportin financiar për vitin paraprak siç është aprovuar nga Komisioni për Buxhet dhe Financa;
- 2.8 detajet e të gjitha vendimeve të Gjykatës Themelore — Departamenti në lidhje me OSHP-në, apo të gjitha ankesat e shqyrtuara në Gjykatë Themelore;
- 2.9 Nevoja për punëtor të rinj;
- 2.10 detajet e buxhetit dhe personelit të OSHP-së;
- 2.11 detajet rreth hapësirave fizike të institucionit;
- 2.12 vlerësim të gjendjes së mbrojtjes ligjore dhe prokurimit publik në përgjithësi;
- 2.13 raporti rreth adresimit të raportit të Auditorit të Përgjithshëm.

Neni 37
Tranzicioni dhe dispozitat përfundimtare

1. Rregullorja e Punës Nr. 01/2020 hynë në fuqi pas publikimit në faqen e internetit të OSHP-së.
2. Rregullorja e Punës e OSHP-së Nr. 01/2017 shfuqizohet nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.

Prishtinë më 26 shkurt 2020

Organi Shqyrtues i Prokurimit
Blerim DINA, Kryetar

